



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Plani i Integruar i Ministrisë 2008


Mesazhi i Ministrit

Gjatë vitit 2007, Ministria e Brendshme ka punuar në përmbushjen me sukses të detyrimeve që burojnë nga Programi i Qeverisë, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Plani Kombëtar i Anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Plani i Integruar i Ministrisë së Brendshme për vitin 2007 si dhe dokumente të tjera strategjike.

Ministria e Brendshme për vitin 2008 ka si prioritet modernizimin e sistemit të gjendjes civile, nëpërmjet ndërtimit të sistemit për pajisjen e shtetasve me Kartën e Identitetit si dhe modernizimin e sistemit të adresave, decentralizimin dhe autonominë vendore, duke synuar rritjen e peshës aktuale të shpenzimeve autonome të pushtetit vendor në buxhetin e shtetit, zgjerimin e autonomisë fiskale të bashkive dhe komunave si dhe përfundimin e procesit të transferimit të pronave në njësitë e qeverisjes vendore, reformimin e administratës publike për krijimin e një administrate të qëndrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit, me nëpunës civilë të rekrutuar dhe të vlerësuar sipas kualiteteve profesionale përmes një procesi të hapur e konkurrues rekrutimi dhe karriere, motivimi dhe shpërblimi si dhe shtrirja e statusit të nëpunësit civil në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike, luftën kundër krimit të organizuar e trafiqeve në përgjithësi dhe drogës e qenieve njerëzore në veçanti, si dhe luftën kundër pastrimit të parave, forcimin dhe garantimin e rendit dhe sigurisë publike, të cilat përbëjnë angazhimin parësor kryesor të Ministrisë së Brendshme për "Tolerancë zero ndaj krimit", uljen dhe parandalimin e krimit ordiner, duke e ndëshkuar dhe duke e gërshetuar atë me masa efektive parandaluese dhe një reformë të thellë në organizimin, shpërndarjen, komandimin, marrëdhëniet me komunitetin, forcimin e sigurisë rrugore përmes ndëshkimit të rasteve të shkeljes së rregullave të qarkullimit.

Këto prioritete të nisura do të vijojnë të mbeten fokusi ynë edhe për vitin 2008 duke synuar finalizimin e tyre, me qëllim përmirësimin e ndjeshëm të punës dhe realizimin me sukses të objektivave të ndërmarra.



Bujar Nishani

Minister i Brendshëm

Pasqyra e lëndës

| | | |
|---|---|----|
| 1 | Misioni i Ministrisë | 5 |
| 2 | Dokumente strategjike të Ministrisë | 7 |
| 3 | Programet buxhetore të Ministrisë..... | 10 |
| 4 | Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008..... | 12 |
| 5 | Plani i Monitorimit të Ministrisë | 18 |
| | Aneksi 1: Projektaktet për t'u paraqitur | 20 |
| | Aneksi 2: Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian..... | 25 |
| | Aneksi 3: Investimet publike | 30 |
| | Aneksi 4: Projekte të ndihmës së huaj | 34 |
| | Aneksi 5: Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit | 36 |

1 Misioni i Ministrisë

Forcimi dhe garantimi i rendit e sigurisë publike, individuale e komunitare do të përbëjë angazhimin parësor të programit të qeverisë i cili është: "Tolerancë zero ndaj krimit".

Lufta kundër krimit të organizuar e trafiqeve

Lufta kundër krimit të organizuar, trafiqeve në përgjithësi dhe atyre të drogës e qenieve njerëzore në veçanti, si dhe lufta kundër pastrimit të parave do të kenë përparësi. Për këtë qëllim do të bëhen edhe ndryshime ligjore në kodin penal për dënime maksimale dhe nivel të prerë dënimi për këto vepra penale.

Angazhimi në luftën kundër terrorizmit

Shqipëria do të përmbushë në mënyrë aktive dhe të përkushtuar të gjithë detyrat dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit si rreziku dhe armiku numër një i paqes, sigurisë dhe jetës së popujve.

Ulja dhe parandalimi i krimit ordiner

Krimi ordiner do të ndëshkohet por lufta kundër tij do të gërshetohet edhe me masat efektive parandaluese. Qytetet, fshatrat, rrugët, rrugicat, bankat e bizneset, lokalet dhe stadiumet dhe çdo cep i vendit do të jenë tërësisht të garantuara dhe siguria publike do të jetë solide dhe e plotë. Në qytetet e mëdha do të investohet në sistemet e monitorimit të pandërprerë elektronik. Organet e rendit publik do t'i nënshtrohen një reforme të thellë në organizimin, shpërndarjen, komandimin, marrëdhëniet me komunitetin, përgatitjen profesionale dhe sigurimit të burimeve njerëzore si dhe do të bëhen të afta të japin edhe shërbime speciale të sigurisë.

Siguria rrugore

Siguria rrugore do të trajtohet gjithashtu me përparësi. Niveli i ulët i sigurisë rrugore merr çdo vit me dhjetra jetë njerëzish dhe shkakton dëme materiale të konsiderueshme. Krahas përmirësimit të cilësisë së rrugëve dhe sinjalistikës rrugore në përputhje me standardet evropiane, përfshirë zbatimin e procedurave të auditimit të rrugëve që nga momenti i projektimit e deri në realizim, forcimi i disiplinës së qarkullimit rrugor, pajisja me leje qarkullimi bazuar në testime realiste dhe të pakorruptuara të drejtuesve të mjeteve nëpërmjet përmirësimit të sistemit të autoshkollave, ristrukturimi i kontrollit teknik të mjeteve dhe edukimi masiv me rregullat e qarkullimit të të gjithë grupmoshave, veçanërisht të moshës shkollore, do të jenë disa nga drejtimet kryesore. Policia rrugore në bashkëpunim me atë bashkiake do të jenë jo vetëm ndëshkuese të rasteve të shkeljes së rregullave të qarkullimit por ato do të shndërrohen në institucione në shërbim të qytetarëve.

Decentralizimi dhe autonomia vendore

Ministria e Brendshme është e angazhuar maksimalisht në funksion të zgjerimit dhe thellimit të procesit të decentralizimit në dobi të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës së komuniteteve. Në projektet e saj, do të zbatojë, në përputhje me Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale dhe Rajonale, me ritme të përshpejtuara dhe të qëndrueshme, dhe në konsultim të vazhdueshëm me qeverisjen vendore e aktorët e tjerë të interesit, një proces që synon të mobilizojë kontributin e të gjithëve në nivel qendror dhe vendor për më shumë autonomi vendore, për institucione vendore të konsoliduara, për administrata të bashkive, komunave dhe qarqeve të afta të sigurojnë për qytetarët dhe komunitetet e

tyre shërbime sa më të mira publike, për më shumë demokraci e pjesëmarrje të qytetarëve në nivel vendor. Implementimi i kësaj reforme decentralizuese të jetë i shpejtë dhe efikas duke bërë të mundur pajtueshmërinë e legjislacionit dhe institucioneve lokale me standardet evropiane.

Gjatë vitit 2008 por edhe në vazhdim gjatë 2009-ës, do të përfundojë procesi i transferimit të pronave në njësitë e qeverisjes vendore, me përparësi ujësjellësat, rrugët, trojet, shoqëritë publike me karakter vendor, objektet social-kulturore.

Do të vihet në zbatim koncepti i funksioneve të përbashkëta në arsim, shëndetësi, mjedis, strehim, shërbime sociale, rend dhe qarkullim rrugor, për të cilat njësitë e qeverisjes vendore do të marrin vendime autonome brenda sferës së juridiksionit të tyre dhe do të bashkëpunojnë, bazuar në parimin e autonomisë, subsidiaritetit dhe partneritetit, me qeverisjen qendrore si dhe mes vetë njërive të qeverisjes vendore, për arritjen e objektivave kombëtare në këto fusha, sipas prioriteteve vendore për secilën prej këtyre njërive. Alokimi i fondeve për qeveritë vendore në këta sektorë publikë do të kryhet në mënyrë objektive dhe transparente, duke synuar ngushtimin e disbalancave rajonale të derisotme.

Kufijtë e njërive të qeverisjes vendore janë të garantuara me ligj. Çdo ndryshim i mundshëm i tyre do të bëhet në favor të progresit e mirëqeverisjes dhe sipas procesit të hapur e përfshirës bazuar në parimet e Kushtetutës dhe të ligjit organik të qeverisjes vendore.

Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike

Në projektin e saj të ndryshimit, qeveria angazhohet për një shërbim më të mirë ndaj qytetarëve. Qeveria do të kryejë një reformë të thellë e të vërtetë të administratës publike për krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe eficient, si dhe të një administratë të qendrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit dhe të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët, e aftë të prodhojë e të zbatojë politika, me nëpunës civilë të rekrutuar dhe të vlerësuar sipas kualiteteve profesionale, eksperiencës, meritës dhe përkushtimit në kryerjen e detyrave.

Mazhoranca e re angazhohet për një qeveri të vogël njëherazi në dietë. Shpenzimet qeveritare të natyrës jo-produktive e të luksit do të eliminohen ndërsa do të përgjysmohen shpenzimet administrative të qeverisë në tërësi.

Ministritë dhe të gjitha institucionet e tjera ekzekutive do të bëjnë transparente dhe me anë të zyrave për informimin e publikut të gjithë veprimtarinë e tyre.

Ministritë dhe institucionet e tjera në varësi të qeverisë do të ristrukturohen ndërsa do të mbyllën ose shkurtohen një rrjet i tërë institucioneve e zyrash parazitare.

Administrata publike do të forcohet e konsolidohet sipas principeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Qeveria do ta njohë dhe respektojë statusin e nëpunësit civil për çdo punonjës që e ka fituar atë me meritë dhe ai do të jetë i garantuar. Ajo do të përmirësojë kualitetet profesionale në administratën publike nëpërmjet një procesi të hapur e konkurrues rekrutimi e karriere, motivimi e shpërblimi të performancës së mirë dhe ndëshkimit të performancës së dobët e pandershmerisë së nëpunësve si dhe trajnimit të vazhdueshëm. Statusi i nëpunësit civil do të shtrihet në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike, ndërsa pagat në sektorin publik do të rriten njëkohësisht me ngushtimin në 1 me 5 të diferencave të mëdha që ekzistojnë sot mes pagës maksimale dhe minimale.

2 Dokumente strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e rendit publik

Kjo strategji është miratuar me VKM-në Nr.14, Datë 09.01.2008, dhe është në fazën e zbatimit nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Strategjia ndërsektoriale e decentralizimit

Në kuadër të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 134, Datë 12.06.2006, Ministria e Brendshme ka organizuar takime me grupet e ndryshme të interesit për të diskutuar ndryshimet në strategji. Gjithashtu strategjia është diskutuar në strukturat e posaçme sektoriale: Grupit të Ekspertëve të Decentralizimit dhe Komitetin Ndërmintor të Decentralizimit dhe pritet të dërgohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut dhe terrorizmit

Projekti i përgatitur është kthyer nga Këshilli i Ministrave me detyrimin për t'u ripunuar duke synuar në detajimin më të mirë të detyrave të institucioneve të shtetit. Është ripunuar një variant dhe është dërguar për marrje mendimi.

Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufijve

Kjo strategji është miratuar me VKM-në Nr. 668, Datë 29.09.2007, dhe është në fazën e zbatimit nga strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit si dhe institucionet e tjera që marrin detyrime prej saj.

Strategjia ndërsektoriale e administratës publike

Me Urdhrin Nr. 134, Datë 16.08.2007, të Kryeministrit është ngritur Grupi Ndërmintor i Punës (GNP), për Përgatitjen, Hartimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP), në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Në zbatim të tij, Ministri i Brendshëm me Urdhrin Nr. 1696, Datë 05.11.2007, "Për ngritjen e Grupit Teknik të Punës, për Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim", ka miratuar ngritjen e Grupit Teknik të Punës (GTP). Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa mbledhje të GTP, si dhe dy mbledhje të GNP. Në mbledhjen e fundit, GNP ka diskutuar mbi draftin e parë të SNRAP. Në bazë të vërejtjeve të bëra në këtë mbledhje, GTP në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë nga SIGMA dhe ekspertët lokalë nga Instituti i Studimeve Bashkëkohore (ISB), kanë ripunuar draft - strategjinë, e cila do të ridiskutohet në mbledhjen e radhës së GNP. Sipas kalendarit të miratuar të veprimeve, parashikohet që hartimi i SNRAP të përfundojë në muajin Qershor 2008.

Dokumente të tjerë strategjikë

Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2008-2010

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Njësia Antitrafik) është duke punuar për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2008-2010. Në këtë kuadër është përgatitur raporti i vlerësimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2005-2007 dhe janë përcaktuar hapat që do të ndiqen për hartimin e Strategjisë së re duke u bazuar

në një plan konkret pune. Gjithashtu, janë zhvilluar takimet konsultative me strukturat zbatuese të strategjisë së mëparshme, si dhe me përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare dhe OJF-ve të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Sipas planit të punës, në vijim të procesit të hartimit të strategjisë së re, gjatë muajit Mars dhe Prill do të organizohen disa seminare, të cilat do të trajtojnë aspekte të veçanta të strategjisë që lidhen me ndjekjen penale, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit, parandalimin si dhe bashkërendimin. Në fund të muajit Prill do të organizohet një konferencë kombëtare për prezantimin e draftit përfundimtar të strategjisë e cila do t'i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave.

Dokument orientues për mbrojtjen civile

Hartimi i këtij dokumenti është në proces. Gjatë diskutimit, kohët e fundit, të projektit të Bankës Botërore (Proposed Disaster Risk Mitigation and Adaptation) për Shqipërinë janë trajtuar, si dhe janë planifikuar, në mënyrë paraprake, veprimtari, mjete dhe struktura, që duhen marrë parasysh në këtë strategji. Në këtë kuadër, krahas punës tonë në vazhdim, nevojitet bashkëpunimi me këtë institucion, duke koordinuar objektivat me planifikimin e fondeve dhe instrumenteve zbatues, si elementë të rëndësishëm për këtë strategji.

Hartimi i Strategjisë për Mbrojtjen Civile është në vazhden e zbatimit të politikave të Qeverisë, Misionit të Ministrisë së Brendshme si dhe në kuadrin e Strategjisë së Rendit Publik. Nëpërmjet këtij dokumenti, synohet të zbatohen detyrimet që vihen në PKZMSA-së, duke harmonizuar më mirë proceset e tanishme në fushën e mbrojtjes civile me ato që lidhen me drejtimit kryesorë të zhvillimit të vendit, sot dhe në të ardhmen, në rritjen e sigurisë për jetën e qytetarëve, në mbrojtjen e pronës, mjedisit dhe trashëgimisë kulturore.

Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Brendshme dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në 10% deri në vitin 2012 krahasuar me 2007.
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore brenda Administratës Publike, lidhur me punësimin, zhvillimin dhe shpërblimin e nëpunësve civilë si një menaxhim i orientuar drejt rezultateve në 15% në vitin 2012 krahasuar me 2007.
- Rritja e kërkesave për trajnim të nëpunësve civilë sidomos në fushën e aftësive menaxheriale me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve si dhe një përgjigje efektive ndaj nevojave për zhvillim të shërbimit civil në 20% në vitin 2012 krahasuar me 2007.
- Krijimi i një sistemi unik dhe të informatizuar të kontabilitetit brenda vitit 2010. Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe mbështetjes administrative për gjithë programet e ministrisë në 20% në vitin 2012 krahasuar me 2007.
- Rritja e performancës në nivel vendor në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët. Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të përdorimit të fondeve publike nga agjenci dhe organe me varësi qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore.
- Ngritja e regjistrit kombëtar i cili bazohet në një bazë kombëtare të dhënash që ka aftësinë të regjistrojë të gjitha aktet e shërbimit të gjendjes civile, të jetë e përdorshme on-line si brenda ashtu dhe në shërbimin konsullor, t'i japë informacion institucioneve të tjera, të lëshojë certifikata të çdo lloji të printuara duke rritur cilësinë dhe saktësinë e shërbimit, ngritja dhe shfrytëzimi i sistemit të adresave.

- Shmangia e të papriturave, realizimi në kohë i ndihmave dhe zbutja në maksimum e pasojave dhe nevojave ekonomike dhe ushqimore në zonat, komunat apo fshatrat që preken nga fatkeqësi natyrore.
- Përmirësimi i gamës së mallrave që klasifikohen si mallra rezervë shteti dhe mbajtjen e tyre si stoqe në qendër dhe në zona të njohura me rrezikshmëri natyrore për të qenë në gjendje që me këto mallra për çdo vit në PBA të ndihmohen rreth 30 000 banorë.
- Në vitin 2013 krahasuar me vitin 2007, Policia e Shtetit të ketë realizuar:
 - Reduktimin e nivelit të krimit të organizuar dhe terrorizmit në masën 35%.
 - Rritjen e shkallës goditëse, zbulimit dhe parandalimit të veprimtarisë dhe kalimit të paligjshëm të kufirit në masën 70%.
 - Reduktimin e krimit dhe sjelljes antishoqërore në masën 40%.
 - Rritjen e sigurisë në rrugë në masën 30%.
- Përmirësimi i sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja dhe Objekteve të Rëndësisë së Veçantë sa më afër 100% duke siguruar përputhje me standardet më të larta evropiane deri në vitin 2015.
- Rritja e sigurisë ndaj zjarrit në komunitet, minimizim i rasteve të zjarreve dhe dëmeve që ato shkaktojnë.
- Rritja e cilësisë dhe shpejtësisë së ndërhyrjeve operacionale, raste zjarri apo shpëtimi, nëpërmjet vetësigurimit të jetës së zjarrfikësve, veshje, aparate diktim mbrojtëse etj.
- Ofrimi i shërbimit në kohën më të shkurtër të mundshme në përputhje me standardet evropiane sipas kritereve: ndarje administrative, numër zjarrfikësish për numër banorësh, rreze mbulimi e veprimi për stacion dhe automjet zjarrfikësi.
- Rritja e profesionalizmit të strukturave parandaluese dhe operuese të shërbimit zjarrfikës, nëpërmjet trajnimit dhe sigurimit të kushteve të punës, stërvitjes dhe jetesës.
- Përgatitja e punonjësve të rinj të nivelit zbatues të cilët bëjnë të mundur riaftësimin e trupës policore për shkak të daljes në pension të punonjësve, pamundësisë për të punuar në strukturat e policisë etj.
- Kalimi në trajnim të avancuar të rreth 5000 punonjësve të policisë të nivelit zbatues duke filluar nga viti 2008. Këtë trajtim do ta përfitojnë 1000 punonjës në vit, për një periudhë kohe 5-vjeçare.
- Kalimi në nivel trajnimit të punonjësve të policisë të nivelit të parë, të mesëm dhe të lartë drejtues, për rritjen e aftësive menaxhuese të organizimit, drejtimit të institucioneve policore në bazë e në qendër.
- Përmirësimi në vazhdimësi i infrastrukturës së mësimdhënies nëpërmjet shtimit të bazës materialo-didaktike dhe krijimit të ambienteve të përshtatshme për mbarëvajtjen e mësimin.
- Rritja e performancës së punës të Administratës.
- Përmirësime në indikatorët që influencojnë në rritjen e sigurisë së qytetarëve të kërcënuar ose të goditur nga fatkeqësi.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin, menaxhimin dhe funksionimin e Ministrisë së Brendshme nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e politikave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve si dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të Ministrisë. Fuqizimin e kapacitetit funksional të Departamentit të Administratës Publike me qëllim implementimin sa më të mirë të reformës në administratën publike duke përmirësuar dhe ngritur nivelin e njohurive dhe aftësive të lidhura me standardet e BE-së, për të gjithë nëpunësit civilë si në procesin e vlerësimit të pozicioneve të punës, në sistemin e pagave dhe në procesin e rekrutimit të nëpunësve civilë. Trajnimin e nëpunësve civilë nga ITAP-i, përmirësimin e aftësive profesionale dhe përmirësimin e bazës së njohurive, në mënyrë që çdo nëpunës civil të kontribuojë në mënyrë optimale për arritjen e qëllimit të institucioneve.

3.2 ARSIMI DHE SHKENCA (AKADEMIA)

Politika e këtij programi konsiston në ngritjen e një trupe pedagogjike të aftë profesionalisht, të orientuar drejt njohjes dhe perfeksionimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, për të transmetuar tek brezi i ardhshëm njohuritë e policimit bashkëkohor, si dhe ngritjen e nivelit tekniko shkencor të punonjësve të nivelit të parë drejtues, të nivelit të mesëm dhe atij të lartë drejtues, me qëllim që të përgatisë punonjës policie të aftë në mbrojtje të rendit dhe sigurisë publike.

3.3 POLICIA E SHTETIT

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e menaxhimit të veprimtarisë së gjithë strukturave të Policisë së Shtetit për forcimin e garantimin e rendit dhe sigurisë publike, individuale e komunitare, sipas motos “Tolerancë zero ndaj krimit”, përafrimin e standardeve dhe procedurave të operimit të policisë me ato të vendeve të BE-së për t’i shërbyer më mirë komunitetit, thellimit të bashkëpunimit sa më efektiv brenda dhe jashtë vendit si dhe planifikimi dhe përdorimi sa më racional të burimeve njerëzore e materiale.

3.4 GARDA E REPUBLIKËS

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja në një nivel sigurie maksimal dhe ruajtjen e Objekteve të Rëndësisë së Veçantë.

3.5 PREFEKTURAT DHE FUNKSIONET E DELEGUARA TË PUSHTETIT VENDOR

Politika e këtij programi konsiston në forcimin e rendit kushtetues, koordinimin e veprimtarive dhe kontributeve të institucioneve qendrore me ato vendore, për një zhvillim lokal dhe rajonal të qëndrueshëm, zbatimin e programit të qeverisë nga institucionet qendrore në nivel lokal, përdorimin me efikasitet të fondeve buxhetore që u akordohen njësive vendore dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Strukturat lokale të

administrimit dhe mbrojtjes së tokës synojnë sigurimin e titujve legalë të pronësisë së tokës, si dhe bashkëpunimin me komisione të tjera ndarje.

3.6 SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Politika e këtij programi konsiston në modernizimin e shërbimit të gjendjes civile me qëllim që të përmirësohet ndjeshëm marrëdhënia ndërmjet shtetasve dhe institucioneve shtetërore dhe shërbimi i ofruar në zyrat e gjendjes civile. Kjo do të rrisë seriozitetin e shtetit në raport me qytetarët dhe nga ana tjetër do të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për përgjegjësitë dhe detyrimet që ata kanë, siç janë raportimi në kohë dhe me saktësi i të gjitha ndryshimeve të tyre në përbërësit e gjendjes civile, në vendbanim, etj. Në këtë mënyrë, do të bëhet i mundur një "inventar" i plotë, i saktë dhe i përditësuar i të gjithë shtetasve. Nga ana tjetër do të mundësohet identifikimi i tyre me anë të Kartës së Identitetit si dhe lokalizimi i saktë në terren. Në këtë mënyrë do të ketë një njohje më të mirë të terrenit dhe rrjedhimisht shpërndarje më të mirë të fondeve për pushtetin lokal. Nga ana tjetër qytetarëve do t'u ofrohet një shërbim bashkëkohor, dinjitoz dhe më afër nevojave të tyre.

3.7 SHËRBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI (M.N.Z.)

Politika e këtij programi konsiston në përshtatjen e akteve ligjore dhe nënligjore me standardet bashkëkohore evropiane, ofrimin e shërbimeve nga shërbimi zjarrfikës ndaj komunitetit me cilësi dhe siguri, dhe me shpejtësi, sigurimin e jetës së zjarrfikësve, me moton "vetësigurim dhe ndërhyrje optimale për komunitetin", mbulimin e territorit të vendit me shërbimet e PMNZSH-së, sipas kriterëve dhe standardeve evropiane

3.8 EMERGJENCAT CIVILE

Politika e këtij programi konsiston në planifikimin, informimin, koordinimin e të gjitha strukturave të Emergjencave Civile, duke garantuar përdorimin e të gjitha burimeve të mundshme, me qëllim rritjen e sigurisë publike, lokalizimin e zonës së emergjencës, shpëtimin e jetës, lehtësimin e pasojave, reagimin e integruar të strukturave përkatëse dhe riaftësimin e zonave të dëmtuara, përafrimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare të shërbimit të Emergjencave Civile në mbrojtje të jetës së qytetarëve, gjësë së gjallë, pronës publike dhe private, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit. Kjo strukturë vlerëson rreziqet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, nëpërmjet fuqizimit të strukturave planifikuese, operacionale aktive dhe mbështetëse, parandaluese dhe kontrolluese, sistemeve të integruara të komunikimit, fondeve dhe burimeve mbështetëse, edukimit, trajnimit, bashkëpunimit me organet e qeverisjes vendore dhe strukturave ndërkombëtare anologe.

3.9 MENAXHIMI I REZERVAVE TË SHTETIT

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e mallrave rezervë të shtetit, të mallrave të ndihmës humanitare, mallrave dhe materialeve të sekuestruara ose konfiskuara. Mbajtja në gatishmëri gjatë vitit e një sasive të caktuar stoku mallrash e materialeve, në qendër si dhe stoqe preventive në zona me rrezikshmëri. Përmirësimi i kushteve të akomodimit në magazina, rritja e rendimentit në pritje dhe në shpërndarje të mallrave dhe materialeve në periudha e situata emergjente. Mirëmbajtja dhe mbajtja në gatishmëri të plotë e mjeteve të transportit të domosdoshëm për transportin e këtyre mallrave.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria e Brendshme do të ofrojë produktet e mëposhtme në vitin 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Plotësimi i kërkesave për trajnim të nëpunësve civilë në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për të përmirësuar sistemin e rekrutimit të nëpunësve civilë, të zhvillimit e të karrierës dhe vlerësimit të rezultateve të punës, në masën 10% në vitin 2008 në krahasim me 2007.
- Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të menaxhimit të fondeve të Aparatit të Ministrisë së Brendshme në 8% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.
- AITPP (Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pasurive të Paluajtshme) do të synojë ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të aktivitetit të agjencisë në qendër dhe në qarqe në masën 6% në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.
- Rekrutimi i nëpunësve duke patur parasysh menaxhimin e orientuar drejt rezultateve, në masën 10% në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007.

Produktet që do të ofrohen

- 2.918 persona të trajnuar.
- Përmirësimi dhe modernizimi i ndërtesës ekzistuese.
- 1 ndërtesë e rikonstruktuar.
- Blerja e 40 pajisjeve kompjuterike dhe software.
- Funkcionimi i faciliteteve të krijuara për pushimet e punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme.

4.2 ARSIMI DHE SHKENCA (AKADEMIA)

Objektivat e politikës:

- Përgatitja e 200 punonjësve të rinj të policisë të nivelit zbatues për një periudhë 10 mujore.
- Trajnimi i 100 punonjësve të policisë të nivelit zbatues të cilët janë aktualisht në marrëdhënie pune në policinë e Shtetit.
- Trajnimi për një periudhë 10 mujore i 60 punonjësve të niveleve të larta të menaxhimit të policisë së Shtetit nisur nga niveli i gradave do të jenë si më poshtë:
 - 20 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
 - 30 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
 - 10 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- Përmirësim i infrastrukturës nëpërmjet shtimit të stokut material për shumën 5.760 mijë lekë për blerje të pajisjeve kompjuterike, fotokopje, krijim fond biblioteke, blerje dhe instalim kondicioner, blerje pajisje për policinë, blerje softe informatike, blerje orendi zyre, etj.

- Rritja e nivelit menaxhues të Administratës së Akademisë së Policisë, duke bërë të mundur përmirësimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e programit mësimor.

Produktet që do të ofrohen

- Përgatitja e 200 punonjësve të policisë të nivelit zbatues për një periudhë 10 mujore.
- Trajnimi intensiv i 100 punonjësve të nivelit zbatues për një periudhë 10 mujore.
- Trajnimi i 60 punonjësve të niveleve drejtuese.
- Trajnimi i 104 punonjësve të administratës së Akademisë së Policisë.
- Trajtimi i 54 punonjësve në reformë.
- Blerja e 200 librave profesionalë.
- Ndërtimi i fushës së futbollit për stërvitjen e studentëve.

4.3 POLICIA E SHTETIT

Objektivat e politikës:

- Rritja me 7% e numrit të operacioneve policore kundër grupeve me aktivitet kriminel organizuar dhe trafikun e lëndëve narkotike, krahasuar me vitin 2007.
- Rritja me 8% e zbulueshmërisë së krimeve të hapura dhe e punës parandaluese për aktet terroriste krahasuar me vitin 2007.
- Shtimi me 8% i rasteve të goditjes për korrupsion, sidomos në sektorin publik krahasuar me vitin 2007.
- Ulja e rasteve të trafikimit të drogës dhe të rasteve të kultivimit të bimëve narkotike në masën 7% krahasuar me vitin 2007.
- Ulja e rasteve të krimeve të rënda kundër jetës, vjedhjes së lokaleve, banesave dhe makinave në masën 5% krahasuar me vitin 2007.
- Rritja e sigurisë rrugore duke synuar një ulje të aksidenteve rrugore 6% krahasuar me vitin 2007.
- Shërbimet e Pikave të Kalimit Kufitar do të rrisin me 12% shkallën e zbulimit, parandalimit dhe goditjes së veprimtarive dhe kalimeve të paligjshme të kufirit, krahasuar me vitin 2007.

Produktet që do të ofrohen

- 35 operacione policore.
- 92 operacione vëzhgimi sekret.
- 75 vëzhgime.
- 4 fushata antidrogë kundër kultivimit të drogave dhe përdorimit të tyre.
- 8.450 prezenca në zonë.
- 24 orë prezenca e Policisë në Pikat e Kalimit Kufitar.
- 182.500 patrullime policore.
- 11.000 qyrrje aksidentesh me pasoja dëmtime njerëzish e dëmtime mjetesh.
- Sisteme funksionale të IT-së.
- 1.783 persona të trajnuar.

- 445 pajisje armatimi.
- 14 pajisje speciale interceptuese vëzhgimi.
- 2 pajisje për laboratorin e Policisë Shkencore.
- 150 aparate e pajisje teknike, fikëse zjarri 6 kg.
- 4 pajisje speciale interceptuese vëzhgimi (Modul).
- 103 aparate e pajisje teknike, fikëse zjarri 5 kg.
- 50 aparate e pajisje teknike, fikëse zjarri 50 kg.

4.4 GARDA E REPUBLIKËS

Objektivat e politikës:

- Do të synojmë ngritjen e nivelit të sigurimit në një nivel prej 15 % më të lartë se ai i vitit 2007.
- Në fushën e personelit do të synojmë trajnimin në masën 8% të stafit të nivelit të lartë.
- Do të synojmë trajnimin në masën 15% të stafit të nivelit të mesëm.
- Do të synojmë trajnimin në masën 20% të stafit të nivelit të ulët.
- Do të synojmë freskimin në masën 15% të materialeve të rezervës së emergjencës.
- Do të përmirësohet dhe tipizohet në masën 15% inventari i mjeteve të transportit.
- Do të synohet zëvendësimi në masën 20 % i armatimit në përdorim për efektivin e Gardës së Republikës.
- Do të synohet përmirësimi i normës së ushqimit me të cilën trajtohet efektivi Gardist.
- Do të synohet zhvillimi i sistemit të radio komunikimit në grupin e Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Parlamentit, si dhe kalimi nga sistemi analog në atë shifror për këto grupe.
- Do të synohet inventarizimi, regjistrimi dhe certifikimi i pasurive të paluajtshme të Gardës së Republikës

Produktet që do të ofrohen

- Mbrojtja e 100 personave VIP.
- Ruajtja e 50 objekteve nga efektivat e Gardës së Republikës.
- Mirëfunksionimi i Administratës Qendrore të Gardës së Republikës.
- Trajnimi i 43 personave.
- Blerja e 1 aparati të ri për ndërlihdjen.

4.5 PREFEKTURAT DHE FUNKSIONET E DELEGUARA TË PUSHTETIT VENDOR

Objektivat e politikës:

- Rritja e efektshmërisë së kontrollit të akteve të pushtetit vendor 6% mbi vitin 2007 (Akte të kthyer për shqyrtim ose të dërguara në gjykatë) si dhe koordinimi i të gjitha veprimtarive të nivelit qendror me atë vendor.
- Rritja e efektshmërisë së auditimeve dhe kontrolleve të organeve të vartësisë, institucioneve vendore dhe të organeve të tjera të qeverisjes vendore 6% (masa të dhëna dhe të ekzekutuara për shkelje financiare).

Produktet që do të ofrohen

- 20.000 akte normative që parashikohen të kontrollohen.
- 440 kontrolle që do të realizohen.
- 1.000 takime që do të realizohen.
- 8 zyra dhe godina të rikonstruktohen.
- 15 pajisje të ndryshme të blera për funksionimin normal të punës.

4.6 SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Për sa i përket dy pikave të para këto janë objektiva të rishikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në krahasim me PBA-në 2008-2010 brenda fondeve të parashikuara për vitin 2008.

Objektivat e politikës:

- Ndërtimi i Regjistrisë Kombëtare elektronike të Gjendjes Civile për evidentimin e saktë dhe të shpejtë të ngjarjeve në lidhje me ndryshimet në të dhënat e gjendjes civile të shtetasve, proces i cili do të shkurtojë kohën dhe procedurat për këtë qëllim, duke siguruar përmirësimin e shërbimit ndaj shtetasve. Rikonstrukcioni i zyrave të gjendjes civile si dhe ofrimi i informacionit palëve të treta. Ruajtja e të dhënave personale në përputhje me ligjin.
- Ngritja e një sistemi bashkëkohor të adresave, duke realizuar përfundimisht lidhjen e shtetasit me territorin, me qëllim rritjen cilësore të shërbimeve ndaj tij. Prodhimi dhe vendosja e tabelave për emërtimin e shesheve, parqeve, bulevardëve, rrugëve, rrugicave dhe numërtimin e ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve. Krijimi i Regjistrave Vendorë dhe Regjistrisë Kombëtare të Adresave.
- Ndërtimi i sistemit për pajisjen e shtetasve me Kartën e Identitetit dhe pasaportën elektronike, i cili përveç pajisjes së shtetasve me një dokument të besueshëm identifikimi do të shmangë nevojën e tyre për t'u pajisur periodikisht me certifikatë personale si dhe do të japë një dokument udhëtimi të standardeve të pranuar.
- Ndërtimi i Qendrës së Personalizimit të Dokumentit të Identitetit dhe pasaportës elektronike, shpërndarja e qendrave të aplikimit, trajnimi i personave që do të mbledhin aplikimet.

Produktet që do të ofrohen.

- Ngritja e sistemit të informatizuar për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave.
- Pajisja e shtetasve me Kartë Identiteti dhe Pasaporta.
- Rikonstrukcioni i zyrave të Gjendjes Civile.

4.7 SHËRBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI (M.N.Z.)

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor.
- Rritja e sigurisë ndaj zjarrit në komunitet, minimizimi i rasteve të zjarreve dhe dëmeve që ato shkaktojnë.
- Hartimi dhe miratimi i ligjit të amenduar “Për mbrojtjen nga zjarri”. Ngritja e grupeve të punës. Sigurimi i kushteve të punës, stërvitjes, jetesës në ambientet ekzistuese, nëpërmjet rikonstrukcionit, përkthime, studime përshtatje normash dhe rregulloresh.

Produktet që do të ofrohen

- 1.900 ndërhyrje operacionale të realizuara.
- 10.000 akte parandalimi.
- 37 persona të trajnuar.
- 140 uniforma të blera.
- 50 uniforma mbrojtëse për personelin.

4.8 EMERGJENCAT CIVILE

Objektivat e politikës:

- Financimi i 3 - 5 objekteve infrastrukturore kryesisht në komuna me mundësi të pakta financiare dhe në zona suburbane, të cilat influencojnë në parandalimin dhe sigurimin e kushteve normale jetese.
- Sigurimi i burimeve financiare për financimin e dëmeve të shkallës së vogël në 2 - 4 objekte të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme në bashki dhe komuna të vogla.
- Dhënia e ndihmës financiare për mbulimin e 80% të kërkesave për ndihmë të banorëve banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi.

Produktet që do të ofrohen

- Zbatimi i masave parandaluese.
- Riaftësimi i objekteve të dëmtuara nga fatkeqësi.
- Dhënie ndihme shtetasve për banesa të dëmtuara nga fatkeqësi.

4.9 MENAXHIMI I REZERVAVE TË SHTETIT

Objektivat e politikës:

- Përmirësimi i kushteve për ruajtjen dhe administrimin në kushte optimale të kontingjenteve të përcaktuara si mallra rezervë shteti dhe të mallrave të tjerë, gjë që do të sjellë një përmirësim të kushteve krahasuar me vitin 2007, me rreth 20%.
- Një administratë e kualifikuar dhe fleksibël për t'iu përgjigjur në kohë situatave emergjente nëpërmjet trajnimeve sistematike dhe përmirësimit të kushteve të punës.
- Rikonstruksioni i kapaciteteve strehuese dhe magazinuese, përmirësimi i kushteve të akomodimit dhe magazinimit të mallrave ku krahasuar me vitin 2007 do të ketë një rritje në masën 30%.

Produktet që do të ofrohen

- Ruajtja në kushte optimale e mallrave rezervë, sekuestro etj.
- 8 pajisje kompjuterike dhe fotokopje.
- Rikonstruksion ambientesh strehuese për mallrat rezervë shteti, të ndihmës humanitare, sekuestrove.

Tabela; Buxheti për vitin 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lekë

| Programet | Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601 | Mallra dhe shërbime 602 | Subvecionet 603 | Të tjera transferta korrente 604, 605 | Transferta për buxhetet familjare dhe individët 606 | Shpenzim e kapitale 230, 231 | Total |
|--|---|----------------------------|--------------------|--|--|---------------------------------|---------------|
| Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 357 | 204 | 0 | 0 | 0 | 1,208 | 1,769 |
| Arsimi dhe Shkenca (Akademia) | 132 | 64 | 0 | 0 | 0 | 5 | 201 |
| Policia e Shtetit | 7,729 | 1,967 | 0 | 0 | 0 | 1,377 | 11,074 |
| Garda e Republikës | 788 | 285 | 0 | 0 | 0 | 37 | 1,110 |
| Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të Pushtetit Vendor | 385 | 63 | 0 | 0 | 0 | 5,5 | 454 |
| Shërbimi i Gjendjes Civile | 252 | 53 | 0 | 0 | 0 | 508 | 814 |
| Emergjencat Civile | 557 | 62 | 0 | 43 | 0 | 1,269 | 1,931 |
| Total (buxheti i ministrisë) | 10,202 | 2,700 | 0 | 43 | 0 | 4,410 | 17,355 |
| Menaxhim i Rezervave të Shtetit | 90 | 15 | - | - | - | 3 | 108 |

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

| Treguesi | Njësia | Qëllimi |
|--|--|--|
| DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE | | |
| Monitorimi i zgjerimit të fushës së veprimit të legjislacionit të shërbimit civil, nëpërmjet këtij treguesi: numri i zyrtarëve dhe institucioneve të përfshira në shërbimin civil; shtrirja vertikale dhe horizontale | Numri i zyrtarëve dhe numri sipas kategorive i institucioneve të përfshira | Zgjerimi i fushës së veprimit nëpërmjet përfshirjes së atyre zyrtarëve dhe institucioneve që nuk janë aktualisht në këtë shërbim |
| Monitorimi i funksionimit të piramidës së shtetit nëpërmjet numrit të nëpunësve civilë sipas niveleve dhe strukturave: 1. Numri i zyrtarëve në vlerë absolute sipas niveleve dhe strukturave. 2. Numri i zyrtarëve në vlerë relative sipas niveleve dhe strukturave. 3. Numri i zyrtarëve sipas niveleve dhe strukturave, në raport me nëpunës me staturë të tjera. | Numri i zyrtarëve | Ndërtimi i institucioneve sipas formës së një piramide me bazë të gjerë dhe me shumë nivele zbatuese |
| Monitorimi i ecurisë së procesit të rekrutimit, si dhe përmirësimi i këtij procesi nëpërmjet këtyre treguesve: 1. Stoku i vendeve të lira. 2. Numri mesatar i aplikantëve për një vend të lirë 3. Rekrutime të suksesshme në raport me totalin. 4. Numri mesatar i ankimimeve për procedurën e rekrutimit 5. Numri i të punësuarve me kontratë | Numri i të punësuarve/numri i ankimimeve | Realizimi në kohë i procedurës së konkurrimit, si dhe mosankimimi i procesit |
| Monitorimi i funksionimit të procesit të karrierës horizontale dhe vertikale nëpërmjet treguesve: përqindja e nëpunësve që ngrihen në detyrë, apo lëvizin paralelisht, përkundrajt totalit | Numri i nëpunësve të ngritur në detyrë ose me lëvizje paralele | Synohet që kjo shifër të rritet krahasuar me 1-2% që është aktualisht |
| Monitorimi i rritjes së kapaciteteve të administratës publike nëpërmjet këtyre treguesve: 1- Numri i nëpunësve të trajnuar. 2- Numri i kurseve të organizuara. 3- Pjesëmarrja në trajnimet e detyrueshme. 4- Shkalla e vlerësimit në fund të trajnimit. 5- Shkalla e dobishmërisë së trajnimeve të marra | Numri i nëpunësve | Synimi është krijimi i një administrate të mirëtrajnuar |
| Monitorimi i ndërtimit të institucioneve sipas modelit të miratuar; përshtatja e strukturave dhe organikave sipas misionit dhe kompetencave të institucioneve në maksimum 4 shtylla kryesore për funksionet e institucioneve: shtylla e politikëberjes, shtylla rregullatore, shtylla e ofrimit të shërbimeve dhe shtylla e shërbimeve mbështetëse. | Numri i institucioneve ku është përfunduar riorganizimi funksional dhe strukturor, si dhe në përqindje të totalit të synuar. | Rritja e numrit aktual |
| Monitorimi i rritjes së pagës dhe reforma në sistemin e pagave nëpërmjet këtyre treguesve: 1- Paga mesatare në shkallë vendi. 2- Paga mesatare sipas sistemeve. 3- Raporti i pagës maksimale me pagën minimale dhe pagën mesatare në shkallë vendi. | Paga mesatare/ Raporti i pagës maksimale me pagën minimale dhe pagën mesatare | Rritja e pagës mesatare dhe i raportit të pagës maksimale me pagën minimale |
| DREJTORIA E PËRGJITHSHME E EMERGJENCAVE CIVILE | | |
| Monitorimi i efektivitetit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri nëpërmjet: | Numri i stacioneve | Synohet të hapen 6 stacione në vitin 2008, të |

| | | |
|---|--|--|
| 1. Numrit të stacioneve zjarrfikës në zonat e banuara 2. Numrit të punonjësve zjarrfikës operues në një stacion | zjarrfikës/ numri i punonjësve zjarrfikës operues | punësohen 100 vetë dhe të trajnohen 147 persona. |
| Zbutja e efekteve sociale nëpërmjet treguesve: 1. Numri i familjeve të dëmtuara, të financuara. 2. Numri i objekteve të vogla të rehabilituara, ndikimi në jetën e banorëve dhe mjedis. | Familjet e financuara dhe objektet e rehabilituara | 70% |
| DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETËTIT | | |
| Numri i krimeve të vrasjes dhe krimeve të tjera të rënda si dhe fuqia zbuluese e policisë . | Numri i krimeve dhe fuqia zbuluese e policisë | 5 % më e lartë se 2007 |
| Identifikimi i sa më shumë shkeljeve të ligjit nga shërbimet në kufi | Numri i shkeljeve të ligjit të identifikuar | 30-40 % |

Aneksi 1: Projektaktet për t'u paraqitur

Decentralizimi

- Projektligji “Për përcaktimin e përgjegjësiave dhe kompetencave të pushtetit vendor për funksionet e përbashkëta”.
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8224, Datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar.
- Projektligji “Për financat vendore”. Ky projektligj synon përcaktimin e qartë të marrëdhënieve fiskale midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, përcaktimin e skemave të financimit dhe të shpërndarjes së parave për çdo bashki, komunë dhe qark, procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit vendor, transparencën dhe raportimin e treguesve financiarë për publikun dhe pushtetin qendror.
- Projektligji “Për buxhetin e shtetit 2009”, për pjesën e buxhetit të pushtetit vendor. Ky ligj do të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe reformat e ndërmarra për decentralizimin, në buxhetin e vitit 2009.
- Hartimi i “Paketës fiskale vendore”. Qëllimi i këtij projektaktit është harmonizimi i politikave makroekonomike me politikat e decentralizimit për vitin 2008.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8927, Datë 25.07.2002, “Për Prefektin”. Ky ligj synon, rritjen e efikasitetit dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut për thellimin e mëtejshëm të decentralizimit administrativ në raport me strukturat e institucioneve qendrore në nivel vendor. Ka përfunduar faza e konsultimit të brendshëm dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Linjës.
- Ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 717, Datë 30.10.2003, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për trajnimin e pushtetit vendor në Shqipëri”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”. Qëllimi i këtij projektakti, është saktësimi i procedurave, roleve dhe kompetencave të aktorëve që marrin pjesë në këtë proces.
- Shpronësime për interes publik.
- Inventarizimi i rrugëve rurale. Synohet që njësitë e qeverisjes vendore të kenë të saktë inventarin e rrugëve për të planifikuar fonde për menaxhimin e tyre.

Departamenti i Administratës Publike

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8549, Datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”. Ky projektligj do të synojë rregullimin në legjislacionin e shërbimit civil, për sa i përket fushës së veprimit dhe procedurave të përcaktuara në të.
- Aktet nënligjore në zbatim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8549, Datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.
- Projektvendimet e Këshillit të Ministrave për rritjen e pagave sipas prioriteteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave për funksionimin e regjistrit qendror të personelit”.

Policia

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin Nr. 7895, Datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” në lidhje me veprat penale në fushën e tatim-taksave, si dhe të korrupsionit pasiv të dëshmitarëve e ekspertëve. Është ngritur grupi i punës dhe po punon për këto ndryshime në bashkëpunim me specialistë të Ministrisë së Financave.
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8610, Datë 17.05.2000, “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Është ngritur grupi i punës me specialistë të Ministrisë së Financave dhe Policisë së Shtetit dhe është duke u punuar projektligji.
- Projektligji “Për luftën kundër terrorizmit”. Në bashkëpunim me specialistë të huaj është hartuar projekti dhe është në fazën e diskutimit së bashku me dokumentin e Strategjisë së Luftës kundër terrorizmit.
- Projektligji “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve”. Është ngritur grupi i punës dhe në bashkëpunim me specialistë të huaj të Konsorciumit të Ambasadave të Huaja në Shqipëri, është duke hartuar një projekt të plotë të këtij ligji.
- Projektligji për Armët. Janë duke u reflektuar mendimet e ardhura prej ministrive të linjës nga grupi i punës.
- Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit”. Janë në fazën e hartimit të projektakteve në zbatim të ligjit “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit”, i cili është miratuar në Janar të vitit 2008.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit”. Është përgatitur drafti dhe është në fazën e diskutimit.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”. Është përgatitur drafti dhe është në pritje të miratimit të projektligjit “Për të Huajt” që është në Parlament.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit tip me elementë të lartë sigurie për të huajt”. Është përgatitur drafti dhe është dërguar në Këshillin e Ministrave për miratim.
- Aktet nënligjore në zbatim të ligjit Nr. 9258, Datë 15.07.2004, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e rregullores së Sektorit Antiterror”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit”. Është përgatitur drafti dhe është në fazën e konsultimeve të brendshme.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për detyrimet financiare në rastet e ofrimit të shërbimeve nga Policia e Shtetit”. Është përgatitur drafti dhe është në fazën e diskutimit brenda strukturave të Policisë së Shtetit.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat e dhënies së medaljeve për punonjësit e Policisë së Shtetit”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për format, përmasat dhe të dhënat e dokumentit identifikues të punonjësit të Policisë”.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Policisë”. Është përgatitur projektregullorja nga grupi i punës dhe është në fazën e reflektimit të mendimeve të dhëna nga Drejtoritë Qendrore të Policisë së Shtetit”.
- Strategjia e Luftës kundër terrorizmit.
- **Plani i veprimit** për kontrollin e armëve të lehta.
- **Plani i Veprimit** për Policinë Rrugore. Është ngritur një grup pune i Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor dhe është duke u përgatitur drafti përkatës.
- Plani i Veprimit Për Policimin në Komunitet.

Garda e Republikës

- Projektligji “Për sigurimin shoqëror suplementar të personave që gëzojnë statusin e punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për përmirësimin e uniformave të Gardës së Republikës”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për modelin e gradave në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për rimbursimin e medikamenteve për punonjësit e Gardës”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar për studimet brenda ose jashtë vendit”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për zëvendësimin e gardistëve me nënoficerë”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e strukturës së Gardës”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e numrit limit të ushtarakëve gardistë që do të zëvendësojnë ushtarët e shërbimit të detyrueshëm aktiv”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së ceremonialit të Truprojës së nderit të Gardës së Republikës së Shqipërisë”.

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

- Projektligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm”. Është përgatitur drafti dhe u është dërguar për mendim Ministrive të linjës.
- Aktet nënligjore në zbatim të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm”.

Emergjencat Civile

- Projektligji “Për mbrojtjen civile nga fatkeqësitë”. I është dërguar për mendim ministrive të linjës dhe janë duke u reflektuar përgjigjet e kthyer.
- Projektligji “Për Inspektoratin e Mbrojtjes Civile”.
- Ndryshimi i Ligjit Nr. 8766, Datë 05.04.2001, “Për policinë e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Ndryshimi i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për Qendrën e Trajnimit të Mbrojtjes Civile”.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në objektet e destinuar për banim”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 206, Datë 26.3.1998, “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 646, Datë 30.09.2004, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së PMNZSH-së”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, Datë 27.06.2002, “Për tarifatat e shërbimeve që kryhen nga PMNZSH ndaj shtetasve dhe personave fizikë, juridikë dhe të huaj”.
- Dokumenti orientues për Mbrojtjen Civile.

Gjendja Civile

- Projektligji “Për Gjendjen Civile”. Është përgatitur projekti dhe u është dërguar për mendim Ministrave të linjës.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9270, Datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”. Ky projektligj është pjesë e paketës ligjore që do të shoqërojë zbatimin e projektit dhe për pasojë edhe ky ligj është parashikuar që do të ndryshojë në disa pjesë të tij duke përfshirë këtu: përcaktimin e përkufizimit të adresës, përcaktimin e sistemit të adresës, përcaktimin e elementëve të adresës, vendosjen e afateve të reja për njësitet e qeverisjes vendore për emërtimin dhe numërtimin e elementëve të adresës. Është duke u përgatitur projektligji nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e afateve për pajisje me Dokument Identifikimi të shtetasve dhe masat shtrënguese për aplikimin e shtetasve për pajisje me Dokument Identifikimi”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për llojin e tabelave, përmasat e tyre, si dhe formatin e shkrimit”.
- Ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 550, Datë. 01.08.2003, “Për tarifatat e shërbimeve që kryhen nga shërbimi i Gjendjes Civile”, i ndryshuar.
- Ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365, Datë 11.06.2004, “Për krijimin dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik”.

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8432, Datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”. Është përgatitur drafti me ndryshimet e bëra në ligjin ekzistues dhe është dërguar për mendim në Ministrinë e linjës.
- Aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9098, Datë 03.07.2003, “Për Integrimin dhe Bashkimin Familjar të personave që kanë përfutur Azil në Republikën e Shqipërisë”. Ka filluar procesi për ngritjen e grupeve të punës.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore

- Projektligji “Për rezervat materiale kombëtare”. Është dërguar në Kuvend dhe pritet të miratohet.

- Aktet nënligjore në zbatim të projektligjit “Për rezervat materiale kombëtare”.
- Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr. 372, Datë 25.07.1994, “Për administrimin e mallrave rezervë shtetërore”. Aktualisht ky projektvendim është në Këshill të Ministrave dhe pritet të miratohet.

Aneksi 2: Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

Departamenti i Administratës Publike

- Ndryshimi i ligjit Nr. 8549, Datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Nga Këshilli i Ministrave është kërkuar hartimi i një strategjie për reformën në administratën publike, në kuadër të së cilës mund të rishikohet edhe ligji i cituar.
- Hartimi akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Statusi i nëpunësit civil". Lidhet ngushtë me masën legjislative për ndryshimin e ligjit "Statusi i nëpunësit civil".
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Policia

- Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit "Për Kufirin". Janë në fazën e hartimit projektaktet në zbatim të ligjit "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit", i cili është miratuar në Janar të vitit 2008.
- Miratim i Urdhrit të Ministrit të Brendshëm "Për krijimin e një Regjistri Kombëtar për të Huajt".
- Miratimi i VKM-së, në zbatim të ligjit të ri "Për të Huajt, "Për hyrjen qëndrimit dhe trajtimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë".
- Nxjerrja e Urdhrit të Ministrit të Brendshëm dhe udhëzimeve për zbatimin e ligjit "Për Kufirin". Pritet miratimi i Ligjit të Ri "Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit".
- Miratimi i Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrit të Shëndetësisë, "Për bashkëpunimin e agjencive, në kufi sipas strategjisë së re të MIK.
- Miratimi i Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Brendshëm "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë".
- Miratimi i akteve për "Analizën e Riskut".
- Miratimi i VKM-së "Për miratimin e dokumentit tip me elementë të lartë sigurie "Për të Huajt". Janë përgatitur dokumentet tip me elementë të lartë sigurie për të huajt dhe janë dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit mes Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe agjencive të tjera kombëtare që operojnë në kufi, si Dogana, Shërbimi Fito- Sanitar.
- Vazhdimi i implementimit të projektit të informatizimit TIMS.
- Projektligji "Për disa shtesa në Ligjin Nr. 9205, Datë 15.03.2004, "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë". Është ngritur grupi i punës dhe në bashkëpunim me specialistë të huaj të Konsorciumit të Ambasadave të Huaja në Shqipëri, është duke hartuar një projekt të plotë të këtij ligji.

- Hartimi i Urdhrit të Ministrit të Brendshëm “Për procedurat standarde të aplikimit të mjeteve speciale të hetimit”. Ka filluar puna për përgatitjen e këtij akti normativ.
- Funksionimi i plotë i Komiteteve Rajonale Antitrafik të ngritura me urdhër të Kryeministrit Nr. 139, Datë 19.06.2006.
- Zbatimi i Marrëveshjes midis Qeverisë së Shqipërisë dhe asaj Greke “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktime të trafikut”.
- Finalizimi i bazës së të dhënave për rastet e viktimave të trafikuarra e të kthyer, të referuara, trajtuara e mbrojtura në Shqipëri.
- Miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për parandalimin e fenomenit të përdorimit dhe shpërndarjes së substancave narkotike në mjediset shkollore”. Është përgatitur projekti që në vitin 2005 dhe i është dërguar për dhënie mendimi Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria e Arsimit dhe shkencës ka kthyer përgjigje. Priten mendimet nga Ministria e Shëndetësisë. Po punohet për riaktivizimin e procesit të miratimit të kësaj marrëveshjeje.
- Krijimi i një magazine qendrore për ruajtjen dhe administrimin e drogave të sekuestruara. Gjatë vitit 2006 është arritur nënshkrimi më datë 2 Maj i një marrëveshjeje teknike mes Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme, Komisionit Evropian, Misionit PAMECA dhe Ministrisë së Jashtme të Britanisë. Një nga pikat e marrëveshjes është edhe implementimi i një projekti të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për të siguruar për palën shqiptare një qendër magazinimi të përhershme të ruajtjes së të gjitha lëndëve narkotike të sekuestruara brenda Shqipërisë, projekt i cili arrin vlerën 74.200 Euro. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Brendshme ka gjetur një ambient në pronësi të saj të përshtatshëm për qëllimin që kërkohet, të cilin e ka vënë në dispozicion të projektit.
- Forcimi i strukturave të luftës kundër pastrimit të parave në qendër dhe strukturat vendore si dhe forcimi i bashkëpunimit me Prokurorinë.
- Hartimi i Strategjisë për Luftën Kundër Terrorizmit në kuadër të Konventave ndërkombëtare të ratifikuara në këtë fushë. Projekti ka përfunduar dhe është në fazën e marrjes së mendimeve. Ky projekt-akt ka si qëllim bashkëpunimin institucional brenda vendit në luftën kundër terrorizmit.
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm në bazë e për zbatim të ligjit për luftën kundër terrorizmit. Ky Udhëzim do të përgatitet pas miratimit të VKM-së për ndryshimin e Rregullores të sektorit antiterror në Policinë e Shtetit.
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Policimin në Komunitet. Kjo është një detyrë e trashëguar që vite më parë dhe parashikohet në Planin Kombëtar të MSA-së. Rekomandimi për hartimin e këtij plani veprimi të veçantë ka ardhur edhe nga Këshilli i Ministrave në momentin kur nuk është parë e arsyeshme të ketë një strategji të veçantë për policimin në komunitet pasi ky komponent është bërë pjesë e Strategjisë së Policisë së Shtetit 2007-2013. Gjatë vitit 2008 do të hartohet një dokument i cili do të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
- Miratimi i Planit të Veprimit në kuadrin e projektit të PNUD/BE “Për Kontrollin e Armëve të Lehta”. Është suprimuar struktura përgjegjëse dhe do të diskutohet me Ministrinë e Mbrojtjes për vazhdimin më tej të këtij projekti.

- Hartimi dhe Miratimi i Planit të Veprimit për Policinë Rrugore që ka si qëllim uljen e nivelit të aksidenteve. Ky Plan Veprimi është parashikuar të hartohet në MSA si dhe në programet e punës dhe për këtë është ngritur një grup pune në Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor dhe është duke u përgatitur drafti përkatës. Gjatë vitit 2008 do të hartohet një dokument i cili do të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Decentralizimi

- Ndryshimi i ligjit “Për nëpunësin civil” për përfshirjen e administratës së komunave dhe institucionin e Prefektit në shërbimin civil. Me mbështetjen e SIPU/DRD, ka filluar puna për amendimin e ligjit. Një konsulent ndërkombëtar është angazhuar nga projekti suedez për konsulencë në këtë drejtim.
- Hartimi i një ligji të ri “Për Prefektin”. Ky ligj synon, rritjen e efikasitetit dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut për thellimin e mëtejshëm të decentralizimit administrativ në raport me strukturat e institucioneve qendrore në nivel vendor. Ka përfunduar faza e konsultimit të brendshëm dhe do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Linjës.
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të pushtetit vendor për funksionet e përbashkëta.
- Hartimi dhe miratimi i ligjit “Për financat vendore”. Ky projektligj synon përcaktimin e qartë të marrëdhënieve fiskale midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, përcaktimin e skemave të financimit dhe të shpërndarjes së parave për çdo bashki, komunë dhe qark, procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit vendor, transparencën dhe raportimin e treguesve financiarë për publikun dhe pushtetin qendror.
- Hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Për huamarrjen vendore”.
- Amendim i ligjit Nr. 8224, Datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar me ligjin Nr. 8335, Datë 23.4.1998.
- Hartimi dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave i draft-vendimeve “Për transferimin e të gjithë Sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore”.
- Ndryshimi i VKM-së Nr. 717, Datë 30.10.2003, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Trajnimin e Pushtetit Vendor në Shqipëri”.
- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri “Për Këshillin e Qarkut”.
- Ngritja e një qendre kombëtare dhe disa qendrave rajonale të trajnimit për pushtetin vendor.
- Projektligji “Për buxhetin e shtetit 2009”, për pjesën e buxhetit të pushtetit vendor. Ky ligj do të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe reformat e ndërmarra për decentralizimin, në buxhetin e vitit 2009.

Gjendja Civile

- Miratimi i VKM-së për Projektin për Prodhimin dhe Shpërndarjen e Dokumentit të Identitetit të Shtetasve Shqiptarë dhe dhënien e Fondit të Ministrisë së Brendshme.

- Miratimi i VKM-së për Vendosjen e afateve për pajisje me Dokument Identifikimi të shtetasve dhe masat shtrënguese për aplikimin e shtetasve për pajisje me Dokument Identifikimi. Kjo VKM do të miratohet në momentin kur të shpallet fituesi i tenderit. Në të njëjtën kohë, do të miratohet edhe formulari i aplikimit për pajisje me Dokument Identifikimi.
- Fillimi i aplikimit të sistemit të adresave sipas kërkesave të ligjit.
- Fillimi i procedurave të aplikimeve për Dokumentin e Identitetit, prodhimi i tij dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit të shtetasve.
- Është miratuar VKM-ja “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues, për projektin koncensionar, ”Prodhimi dhe Shpërndarja e Dokumentit të Identitetit dhe Pasaportave Elektronike”. Kushti për Autoritetin Kontraktues është që brenda Qershorit të vitit 2009 të gjithë qytetarët Shqiptarë të jenë të pajisur me Karta Identiteti.
- Fillimi procesit të Modernizimit të Shërbimit të Gjendjes Civile dhe ngritjes së Regjistrit Kombëtar të Shtetasve.

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

- Projektligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm”. Është përgatitur drafti dhe u është dërguar për mendim Ministrive të linjës.
- Aktet nënligjore në zbatim të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm”.

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët

- Amendime të Ligjit Nr. 8432, Datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”. Drafti i ligjit të ndryshuar është dërguar në Ministrinë e linjës për mendim.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Akt nënligjor i ligjit “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë” që rregullon asistencën sociale të këtyre personave. Ka filluar puna për përgatitjen e Urdhrit të Ministrisë të Brendshme për ngritjen e grupit të punës.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Akt nënligjor i ligjit “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë” që rregullon asistencën shëndetësore të këtyre personave. Ka filluar puna për përgatitjen e Urdhrit të Ministrisë të Brendshme për ngritjen e grupit të punës.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Arsimit. Akt nënligjor i ligjit “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë” që rregullon arsimimin e këtyre personave. Ka filluar puna për përgatitjen e Urdhrit të Ministrisë të Brendshme për ngritjen e grupit të punës.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Rregullimit të Territorit dhe Transporteve. Akt nënligjor i ligjit “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë” që

rregullon strehimin e këtyre personave. Ka filluar puna për përgatitjen e Urdhrit të Ministrisë të Brendshme për ngritjen e grupit të punës. Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar”.

Njësia Antitrafik

- Shtesë në Kodin Penal të një dispozite të re kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë dhe shërbime të tjera të detyruara dhe shitjes së fëmijëve. Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të Ndryshuar”.
- Funkzionimi i plotë i Autoritetit Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar Referues (MKR), i cili bashkërendon procesin e referimit për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimin afatgjatë të viktimave të trafikimit. Është krijuar dhe funksion plotësisht Autoriteti Përgjegjës për Viktimat e Trafikut në Njerëz.
- Funkzionimi i plotë i Komiteteve Rajonale Antitrafik të ngritura me Urdhër të Kryeministrit Nr. 139, Datë 19.06.2006, “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore. Komitetet Rajonale janë ngritur dhe funksionojnë sipas rregullave të përcaktuara në Urdhër të Kryeministrit Nr. 139, Datë 19.06.2007.
- Zbatimi i Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke “Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimat të trafikimit”. Pala shqiptare nuk ka marrë ende notifikim lidhur me ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti Grek.
- Finalizimi i bazës së të dhënave (database) për rastet e viktimave të trafikimit të kthyer, referuara, trajtuara dhe mbrojtura në Shqipëri. Ka filluar instalimi i programit të bazës së të dhënave.

Emergjencat Civile

- Përgatitja e projektligjit për “Mbrojtjen Civile nga fatkeqësitë”. Projektligji i ri është hartuar. Ai u është dërguar ministrive të linjës për mendim. Jemi në pritje të dhënies së mendimeve nga ministrinë dhe më pas diskutimit të projektligjit me drejtuesit e Ministrisë së Brendshme.
- Amendimi i ligjit Nr. 8766, Datë 05.04.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Janë bërë ndryshime në dispozita të veçanta të ligjit (rreth 14 ndryshime).
- Hartimi dhe miratimi i Dokumentit Orientues për Emergjencat Civile bazuar në ligjin Nr. 8756, Datë 26.03.2002, “Për Emergjencat Civile”. Gjatë kësaj periudhe është hartuar skema e dokumentit dhe po punohet për pjesët e draftit dhe për formën e paraqitjes së saj.
- Rishikimi i VKM-së Nr. 206, Datë 26.03.1998, “Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”. Projektvendimi është ripunuar, por procedurat e dërgimit të tij në Këshillin e Ministrave janë varura nga ato të projektligjit “Për mbrojtjen civile”, si dhe nga miratimi i këtij projektligji.

Aneksi 3: Investimet publike

| Programi | Kap | Emërtimi Projektit | Emër Institucioni | Vlera ne leke |
|----------|-----|--|---|---------------|
| 01110 | 01 | Ndërtim rikonstruksion | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 20,000,000 |
| 01110 | 03 | Kontribut qeverisë shqiptare për menaxhimin e tokës urbane dhe sistemimin e adresave | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 100,000,000 |
| 01110 | 03 | Kontribut qeverisë shqiptare për fuqizimin e qeverisjes vendore për prefekturën Dibër kosto lokale | Prefektura Qarkut Dibër | 86,000,000 |
| 01110 | 04 | Kontribut qeverisë shqiptare për menaxhimin e tokës urbane dhe sistemimin e adresave TVSH | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 20,000,000 |
| 01110 | 04 | Kontribut qeverisë shqiptare për rimbursimin e TVSH projekt PNUD | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 30,000,000 |
| 01110 | 01 | Trajnim për administratën publike | Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (3535) | 12,320,000 |
| 01110 | 01 | Rikonstruksion Hotelit Nr. 1 | Shtëpia Pushimit Durrës (0707) | 10,000,000 |
| 01110 | 05 | Rikonstruksion Hotelit Nr. 1 | Shtëpia Pushimit Durrës (0707) | 20,000,000 |
| 01160 | 01 | Rikonst god.Prefekturës Berat | Prefektura e Qarkut Berat | 3,800,000 |
| 01160 | 01 | Rikonst.i zyrave.të pref. Kukës | Prefektura e Qarkut Kukës | 500,000 |
| 01170 | 01 | Projekti "Modernizimi I shërbimit të Gjendjes Civile. | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 500,000,000 |
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH (Rinovim i autoparkut MB) | QSHAMT Tiranë (3535) | 5,000,000 |
| 03140 | 01 | Ndërt.rikonstruksion Reparti | Reparti Delta Forcë Vlorë | 27,440,000 |

| | | | | |
|-------|----|---|---|------------|
| | | Delta Forcë-Vlorë | (3737) | |
| 03140 | 01 | Ndërt.rikonstruksion Komisaritati Policisë Nr.5 Kamez (Vazhdim) | Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë (3535) | 25,263,000 |
| 03140 | 01 | Ndërtim rikonstruksion i Drejtorisë Policisë Qarkut Fier | Drejtoria e Policisë Qarku Fier (0909) | 17,792,000 |
| 03140 | 01 | Studim projektim i Drejtorisë Qarkut | Drejtoria e Policisë Qarku Gjirokastrë (1111) | 1,678,000 |
| 03140 | 01 | Ndërtim rikonstruksion i ambienteve të policisë | Drejtoria e Policisë Qarku Lezhë (2020) | 55,000,000 |
| 03140 | 01 | Studim projektim i komisaritatit | Komisariati i Policisë Kavajë (3513) | 487,000 |
| 03140 | 01 | Ndërtim rikonstruksion i ambienteve të policisë | Komisariati i Policisë Kavajë (3513) | 50,000,000 |
| 03140 | 01 | Blerje armatimi | QFM Teknike Tiranë (3535) | 60,000,000 |
| 03140 | 01 | Pajisje dhe shpenzime instaluese të telekomunikacionit | QFM Teknike Tiranë (3535) | 18,080,000 |
| 03140 | 01 | Shpenzime për rritjen e mjeteve të transportit | QFM Teknike Tiranë (3535) | 30,000,000 |
| 03140 | 01 | Mjete transporti për sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve | QFM Teknike Tiranë (3535) | 5,500,000 |
| 03140 | 01 | Orendi zyre | QFM Teknike Tiranë (3535) | 6,160,000 |
| 03140 | 05 | Pajisje dhe shpenzime instaluese të telekomunikacionit | QFM Teknike Tiranë (3535) | 3,634,000 |
| 03140 | 05 | Pajisje për mbrojtjen nga zjarri | QFM Teknike Tiranë (3535) | 2,134,000 |
| 03140 | 05 | Pajisje për policinë (armatim) | QFM Teknike Tiranë (3535) | 22,286,000 |
| 03140 | 05 | Pajisje për policinë shkencore | QFM Teknike Tiranë (3535) | 7,931,000 |
| 03140 | 05 | Pajisje për policinë kriminale | QFM Teknike Tiranë (3535) | 4,015,000 |

| | | | | |
|-------|----|--|---|------------|
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH (Rehabilitimi i Akademisë së Policisë Faza e dytë) | Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (3535) | 7,000,000 |
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH (Ngritja e një qendre të mbyllur pritjeje për të krijuar lehtësira për të riatdhësuarit e paligjshëm) | Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (3535) | 17,097,000 |
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH (Mbështetje për policinë kufitare dhe administratën doganore në kufi) | Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (3535) | 2,000,000 |
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH (rinovimi i Zyrave të DPP) | Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (3535) | 6,403,000 |
| 03140 | 04 | Rimbursim TVSH(Përmirësimi i infrastrukturës në pikat e veçanta të kontrollit kufitar) | Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (3535) | 2,500,000 |
| 03150 | 01 | Blerje automjesh e armatimesh për Gardën e Republikës | Garda e Republikës Tiranë (3535) | 25,000,000 |
| 03150 | 01 | Studim dhe hapje pusi për furnizim me ujë të grupit Durrës | Garda e Republikës Tiranë (3535) | 400,000 |
| 09420 | 01 | Ndërtim terren sportiv (fushë futbollit) | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 3,300,000 |
| 10910 | 01 | Rikonst.ambj.str.të mall.D.Rez | Drejtoria e Rezervave | 1,000,000 |
| 10910 | 01 | Rikonst.ambj.str.të mall.D.Rez.Tir. | Dega e Rezervës Tiranë | 1,000,000 |
| 10910 | 01 | Rikon.ambj.str.të mall.D.Rez.Pukë | Dega e Rezervës Pukë | 1,000,000 |
| 10910 | 01 | Blerje pajisje zjarrduruese | QFM Teknike Tiranë (3535)(PMNZSH) | 15,300,000 |
| 10910 | 01 | Studim projekt stacioni plazh Durrës | Prefektura e Qarkut Durrës | 200,000 |
| 10910 | 01 | Hartim stud. proj. godina Lezhë | Prefektura e Qarkut Lezhë | 500,000 |

| | | | | |
|-------|----|---|-------------------------------------|----------------------|
| | | Blerje pajisjesh | | |
| 01110 | 01 | Blerje pajisje | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 6,480,000 |
| 01160 | 01 | Blerje pajisje n/pref Lushnjë | N/Prefektura Lushnjë (0922) | 300,000 |
| 01160 | 01 | Blerje pajisje n/pref Përmet | Prefektura e Qarkut Gjirokastër | 400,000 |
| 01160 | 01 | Blerje pajisje zyre për p. Vlorë | Prefektura e Qarkut Vlorë | 500,000 |
| 01170 | 01 | Pajisje për zyrat e Gjendjes Civile | Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme | 8,000,000 |
| 03150 | 01 | Blerje orendi dhe pajisje për Gardën e Republikës | Garda e Republikës Tiranë (3535) | 9,600,000 |
| 03150 | 01 | Blerje pistoleta për shërbimin e armatimit | Garda e Republikës Tiranë (3535) | 2,000,000 |
| 09420 | 01 | Shpenzime për krijim fond biblioteke për Akademinë e Policisë | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 200,000 |
| 09420 | 01 | Blerje dhe instalim kondicionerë për Akademinë e Policisë | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 210,000 |
| 09420 | 01 | Blerje orendi zyre për Akademinë e Policisë | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 400,000 |
| 09420 | 01 | Blerje kompjuterësh për Akademinë e Policisë | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 400,000 |
| 09420 | 01 | Blerje pajisje për policinë për Akademinë e Policisë | Akademia e Policisë Tiranë (3535) | 290,000 |
| | | Totali | | 1,256,500,000 |

Aneksi 4: Projekte të ndihmës së huaj

| Emri i projektit | Donatori | Kosto totale | Financimi 2008 në mijë lekë | Data e mbarimit |
|--|---|---|-----------------------------|---|
| Emergjencat Civile | | | | |
| Zvogëlimi i risqeve të fatkeqësisë. | Banka Botërore | 5.5 milion dollarë | | Miratimi i projekti të bëhet në Qershor 2008 dhe implementimit në Shtator 2008. Faza e parë e projektit do të jetë 3 vjet |
| Përmirësimi logjistikës, pajisje dhe mjete zjarrfikëse. | | 1.250.000 | 1.250.000 | |
| GARDA E REPUBLIKËS | | | | |
| Lëvrimi i një ndihme. | Në bashkëpunimi me palën turke | 300.000 USD | | Gjatë vitit 2008 |
| GJENDJA CIVILE | | | | |
| Regjistri Kombëtar - Asistenca Teknike e OSBE-së. | Komisioni i BE-së, Statistics Norway | | | |
| Sistemi i Adresave - A.T e OSBE | Komisioni i BE Banka Botërore nëpërmjet Projektit "LAND MANAGEMENT" | | | |
| PLANIFIKIM MENAXHIMI | | | | |
| Menaxhimi i tokës urbane dhe sistemi i adresave. | | | 688.000 | |
| Projekt i financuar nga PNUD. | | | 215.000 | |
| POLICIA | | Vlera (Grant) në EURO dhe Vlera e Plotë e Projektit në 000/lekë | | |
| Misioni i Asistencës së Policisë së KE në Shqipëri (PAMECA III). | IPA 2007 | 5.500.000 Euro 673.750 milion lekë | 335.393 | 2010 |
| "Lufta kundër Pastrimit të Parave dhe Krimin Ekonomik" (Projekt binjakëzimi) | Cards 2004 | 200.000 Euro 24.500milion lekë | 12.308 | 2009 |
| Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS). | SHBA | | 98.000 | 2008 |
| Mbështetja e Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit të organizuar, parandalimit të terrorizmit, si dhe sigurimit të integritetit të policisë. | Cards 2005 | 3.000.000 Euro 367.500 milion lekë | 61.540 | 2010 |
| Mbështetje materiale (pajisje dhe trajnim në lidhje me to) për PKM në lidhje me mbikqyrjen dhe patrullimin e kufirit blu. | Cards 2006 | 2.000.000 Euro 245.000 milion lekë | 123.080 | 2009 |
| Rinovimi i Akademisë së Policisë Faza e II-të. | Cards 2004 | 1.090.000 Euro 133.525 milion lekë | 37.724 | 2009 |
| Rinovimi I Autoparkut të Ministrisë së Brendshme. | Cards 2004 | 491.000 Euro 60.148 milion lekë | 47.632 | 2009 |

Plani i Integruar i Ministrisë

| | | | | |
|--|------------|---------------------------------------|-----------|------|
| Forcimi i kapaciteteve të Policisë së Shtetit për mbledhjen e provave në mënyrë të fshehtë. (Projekt binjakëzimi) | Cards 2004 | 1.470.000 Euro 180.075 milion lekë | 73.848 | 2009 |
| Mbështetje për Policinë Kufitare dhe administratën doganore në kufi. | Cards 2006 | 550.000 Euro 67.375 milion lekë | | 2010 |
| Përmirësimi i Infrastrukturës në pika të veçanta të kontrollit kufitar. | Cards 2006 | 2.000.000 Euro 245.000 milion lekë | 64.994 | 2010 |
| Ngritja e një Qendre të Mbyllur Pritje për të krijuar lehtësira për të riatdhesuarit e paligjshëm të vendeve të treta. | Cards 2004 | 1.498.000 Euro 183.505 milion lekë | 145.481 | 2008 |
| PMNZSH | | | | |
| Përmirësimi logjistikës, pajisje dhe mjete zjarrfikëse. | | | 1.250.000 | |
| TOTALI | | | 3.153.000 | |

Aneksi 5: Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Në funksion të thellimit të masave kundër korrupsionit, strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit do të:

Forcojnë strukturat e ngritura për këtë qëllim duke kërkuar riorganizimin e zyrave përkatëse, plotësimin e tyre me burime njerëzore dhe fuqizimin me mjete speciale të hetimit, sidomos në identifikimin e rasteve të korrupsionit dhe sigurimit të provave.

Thellojnë bashkëpunimin me strukturat e ngarkuara me ligj për identifikimin e rasteve të fenomenit të korrupsionit si dhe kryerjen e hetimeve të plota, si me Prokurorinë, me Shërbimet e Kontrollit të Auditit, me SHISH-in, Ministrinë e Financave si dhe Shërbime të tjera.

Ngritjen e sistemit të inteligjencës në drejtim të thithjes së informacionit për vepra penale që lidhen me korrupsionin në gjithë strukturat vendore të policisë sipas organizimit të seksioneve në drejtoritë e policisë së qarqeve.

Hartimin e një plani veprimi antikorrupsion me shtrirje në të gjithë vendin dhe me detyra në zbatim të Strategjisë Antikorrupsion.

Masat kundër korrupsionit nuk prekin vetëm policinë e shtetit që e ka luftën kundër korrupsionit një nga detyrat e saj direkte por edhe institucionet e tjera të Ministrisë së Brendshme dhe përgjithësisht të gjithë shërbimet publike.

Në këtë kuadër mund të përmenden masat antikorrupsion në fushën e reformës së shërbimeve publike, reformimit të procedurave administrative, fuqizimit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik, forcimit të shërbimit civil, decentralizimit të shërbimeve publike dhe luftës kundër korrupsionit në nivel vendor, transparencës dhe integritetit në administratën publike.